

VENDIM
Nr. 40, datë 23.2.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“HYDRO SETA” SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “SETA 1+2”, “SETA 3” DHE “SETA 4”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.2.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2”, me fuqi të instaluar 7454 kw; “Seta 3”, me fuqi të instaluar 2722 kw dhe “Seta 4”, me fuqi të instaluar 4724 kw dhe me fuqi totale të instaluar 14900 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 165 prot., datë 8.2.2018, shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k. ka paraqitur në ERE një kërkesë për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2”, “Seta 3” dhe “Seta 4”.

- Nga analiza e bërë dokumentacionit të paraqitur në këtë aplikim, rezulton se shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4, 4.4.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Neni 9, pika 4.1.4, germa “a” dhe germa “d” do të njoftohet subjekti që ta plotësojë atë brenda afateve që përcakton “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2”, me fuqi të instaluar 7454 kw; “Seta 3”, me fuqi të instaluar 2722 kw dhe “Seta 4”, me fuqi të instaluar 4724 kw dhe me fuqi totale të instaluar 14900 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga

botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti